



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në vazhdimin e dytë të seancës së 55-të, të mbajtur më datë 18.11.2021morri,

VENDIM

Procedura e KSHPK-së për lëndën nr. 08-3629/1 nga 20.10. 2020, i formuar me vetiniciativë, për shkelje të dispozitave të nenit 82 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit nga /// dhe ish ushtrues detyre /// NDËRPRITET.

Konstatohet se pas kërkesave për inicimin e procedurës për kundërvajtje ndaj /// dhe ish ushtrues detyre///, Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK ka miratuar Aktvendimin nr. /// të /// dhe Vendimin nr./// të datës /// me të cilin e shpalli personin përgjegjës për kundërvajtje nga neni 82 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe i shqiptoi sanksione kundërvajtëse me gjobë prej 300 euro në kundërvlerë në denarë.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme ne rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda e regjistruar me numër 08- 3629 të datës 20.10.2020 është formuar me vet - iniciativë.

KSHPK pas marrjes së dokumentacionit dhe nga mbikëqyrja e evidencave të saj konstaton se personi /// me Vendim numër /// të datës /// është shkarkuar nga detyra ///, ndërsa me Vendimin numër /// të datës /// është shkarkuar nga funksioni /// dhe në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të funksionit të lartpërmendur uk dorëzoi listë anketuese në KSHPK.

Për shkak të lartpërmendurës, KSHPK-ja personit të emëruar i ka lëshuar urdhërpagesë për kundërvajtje me /// të datës /// për shkelje të kryer nga neni 82

paragrafi 3 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dënueshëm sipas nenit 109 nga i njëjti ligj.

Personi i emëruar nuk ka vepruar me urdhërpagesë për kundërvajtje në afatin e përcaktuar me ligj, për çka KSHPK ka paraqitur kërkesë në Komisionin për Kundërvajtje në KSHPK për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ndaj personit të caktuar.

Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK me Vendimin nr. /// të datës 1/// e shpalli përgjegjës për kundërvajtje personin e emëruar nga neni 82 paragrafi 3 i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe shqiptoi sanksion për kundërvajtje GJOBË në shumë prej 300 euro në kundërvlerë të denarit.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti:

Miratoi:

KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar
Biljana Ivanovska

